

RAPORT I MONITORIMIT TË PROKURIMIT PUBLIK PËR KOMUNËN E GJAKOVËS

Shkurt 2015

Instituti Demokratik i Kosovës - KDI / Transparency International Kosova - TIK

Ky raport financohet nga Ambasada Britanike në Prishtinë, si pjesë e projektit “Transparenca dhe Llogaridhënia në Prokurimin Publik në Komuna”. Ky projekt ka për qëllim që të rrisë transparencën dhe rregullsinë e proceseve të prokurimit në nivelin lokal në Kosovë, përmes fuqizimit të OJQ-ve lokale për monitorimin e procedurave të prokurimit publik.

Qëndrimet në këtë raport janë të KDI/TIK dhe jo detyrimisht korrespondojnë me qëndrimet e donatorit.



British Embassy
Pristina

Përmbajtja

Hyrje.....	4
Të dhëna të përgjithshme për prokurimin e Komunës së Gjakovës	5
Kontrata për Furnizim me Naftë	7
Tenderi për ndërtimin me kubëza betoni i rrugëve dhe trotuareve	9
Tenderi për Mirëmbajtjen Dimërore të Rrugëve.....	10
Konkluzione	12

Hyrje

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)/Transparency International Kosova (TIK), ka filluar iniciativën e monitorimit të prokurimit publik në nivel lokal, përkatësisht në pesë (5) komuna të Republikës së Kosovës. Ko iniciativë ka lindur pas monitorimit të nivelit qendror, përkatësisht 4 (katër) ministrive të Qeverisë së Kosovës, duke përfshirë Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), Ministrinë e Infrastrukturës (MI) dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Në këto ministri, KDI kë arritur rezultate në evidentimin e problemeve në prokurimin dhe ka avokuar në organet vendimmarrëse, për përmirësimin e shumë dobësive që kanë përcjellë këtë proces. Po ashtu KDI ka bërë procedimin e një numri të konsiderueshëm të rasteve në Prokurorinë e Shtetit, ku ka pasur dyshime se shkeljet janë kryer me qëllim të dëmtimit të qëllimshëm të buxhetit publik.

KDI-ja vazhdon të monitorojë prokurimin publik në pesë (5) komuna të Kosovës përfshirë Prishtinën, Prizrenin, Gjakovën, Gjilanin dhe Mamushën. Këto pesë (5) komuna, janë përzgjedhur nga KDI, duke pas parasysh përfaqësimin politik. Të dhënat e mbledhura për tre lloje tenderësh (tenderët e furnizimit me naftë, mirëmbajtjen e rrugëve dhe tender për shtrim të rrugëve me kubëza të betonit) do të krahasohen për çmimet e kontratave, në mënyrë që të kihet parasysh se me çfarë vlere paguhen produktet e njëjta nga komunat e ndryshme. Gjithashtu do të krahasohen dosjet e tenderëve për të parë se çfarë specifikacione dhe kërkesa kanë komunat e ndryshme në raport me bizneset. Kjo bëhet me qëllim për të parë nëse janë sa duhet të detajuara kërkesat e komunave dhe në anën tjetër nëse bizneset rëndohen me kërkesa të panevojshme ose kërkesa të cilat ulin konkurrencën apo favorizojnë operatorë ekonomik të veçantë.

Synimi i KDI është që përmes këtyre raporteve të ndihmojë komunat që të marrin vlerën për paranë publike të shpenzuar dhe për të evidentuar barrierat administrative për operatorët ekonomikë të cilat dobësojnë konkurrencën e drejtë. Gjithashtu KDI synon t'i informoj qytetarët lidhur me formën se si komunat e tyre kanë administruar me buxhetin e besuar dhe cilat kanë qenë kompanitë që kanë përfituar kontrata publike nga komunat.

Të dhëna të përgjithshme për prokurimin e Komunës së Gjakovës

Komuna e Gjakovës është një nga komunat e cila në zgjedhjet e fundit lokale ka pasur ndërrim të subjektit politik udhëheqës. Pushteti nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka kaluar tek subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR). Pushteti i ri në këtë komunë ka shtuar nivelin e transparencës sidomos në prokurimin publik, madje duke adoptuar një praktikë të re, në të cilën janë publikuar kompanitë fituese të tenderëve dhe vlerat totale që ato kanë marr tender në këtë komunë. Në Indeksin e Transparencës për Prokurimin Publik, të cilin e ka zhvilluar Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), kemi gjetur se Komuna e Gjakovës është në mesin e komunave më transparente në Kosovë, për sa i përket publikimit të dokumenteve që lidhen me prokurim publik.

Komuna e Gjakovës ka buxhet prej 18,629,040.00 euro, prej të cilave, në investime kapitale investohen 5,524,253.00 euro, ndërsa mallra dhe shërbime 1,572,972.00 euro. Këto mjete të komunës shpenzohen përmes procedurave të prokurimit publik. Komuna e Gjakovës ka pasur një numër shumë të madh të anulimit të tenderëve. Komuna e Gjakovës në vitin 2014 ka pas 69 njoftime për kontratë dhe 42 njoftime për dhënien e kontratës. Në vitin 2014 kjo komunë ka pasur 29 njoftime për anulim të tenderëve. Ky numër është shumë shqetësues, pasi që secila procedurë e anuluar përveç që shkakton vonesa në implementim të projekteve, gjithashtu flet edhe për efikasitet të dobët të prokurimit dhe njësisive të kërkesës.

Në anën tjetër për vitin 2014, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), ka nxjerr katër vendime në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara nga Komuna e Gjakovës si autoritet kontraktues. Vendimi i parë është urdhëresë drejtuar Komunës së Gjakovës për respektim të një vendimi paraprak, që do të thotë se komuna nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së. Vendimi i dytë i OSHP-së ka anuluar njoftimin për dhënie të kontratës dhe ka obliguar komunën që projektin “mbikëqyrja profesionale e projekteve-punëve gjatë realizimit” ta kthej në rivlerësim. Vendimi i tretë është vetëm njoftim i OSHP-së pasi që në fazën e shqyrtimit të lëndës nga eksperti i OSHP-së, palët janë pajtuar me opinionin e ekspertit, andaj ka qenë e pa nevojshme që të nxirret vendim i panelit shqyrtues. Në këtë rast lënda ka shkuar në ri-shpallje dhe palët janë pajtuar. Vendimi i katërt po ashtu është njoftim në lidhje me pajtimin e palëve pas nxjerrjes së opinionit të ekspertit shqyrtues të OSHP-së. Ky kontest është kthyer në rivlerësim. Lidhur me dy tenderët e fundit në fakt kjo ka qenë mundësia e vetme e zgjidhjes së problemit, pasi që OSHP nuk ka pas panel shqyrtues, si pasoj e skadimit të mandatit të anëtarëve të OSHP-së. Në anën tjetër Komisioni Rregullativ i Prokurimit në vitin 2013 dhe 2014 nuk ka mbikëqyrur projekte të kësaj komune.

Të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka konstatuar se Komuna ndonëse ka të dizajnuara kontrolle formale mbi shpenzimet, ato nuk operojnë në mënyrën e duhur. Nënshkrimi i kontratave pa zotime të mjaftueshme, shpërblimi i ofertuesve të papërgjegjshëm, mungesa e evidencave për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, po ashtu edhe kontrollet e dobëta tek shpenzimet e derivateve, janë vetëm disa raste që përshkruajnë dështimin e kontrolleve. Kontratat që kanë kaluar nëpërmjet procedurave të prokurimit për vitin 2013 kapin një vlerë prej 7,138,454€.

Auditori ka analizuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në Programin për Investime Publike (PIP) dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Gjithashtu, ka rishikuar edhe ndryshimin e projekteve të parapara gjatë vitit. Vlerësimet janë se sistemi i PIP si një sistem për menaxhimin e investimeve kapitale, nuk ishte përdorë në mënyrën e duhur. Disa kontrata për vitin 2013 nuk ishin të parapara me PIP. Raste të tilla janë me kontratën “Ndërtimi i parkut memorial në fshatin Meje” në vlerë 1,060,774€ dhe “Ndërtimi i rrugës në fshatin Skivjan” në vlerë 800,000€. Për këto kontrata, në sistemin e PIP-it nuk ishte planifikuar buxhet për vitet e ardhshme (2014 dhe 2015). Te kontrata me numër të prokurimit 014 “Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në Çarshinë e madhe në Gjakovë” me vlerë 219,945€, ne nuk e kemi testuar këtë lëndë për arsye se ishte marrur për hetime nga departamenti i krimeve të rënda në Gjakovë.

Tek projekti “Rrethimi i oborrit dhe ndërtimi i terrenit sportiv në gjimnaz” me vlerë 77,222€, komisioni vlerësues kishte ndërhyrë në specifikacionin e ofruar nga kompania fituese te pozicioni numër 9 te kolona e çmimit. Operatori ekonomik kishte ofruar çmimin prej 1€, ndërsa komisioni vlerësues e ka korrigjuar në 1,134€. Sipas Ligjit për prokurim publik (LPP), korrigjimi i çmimeve nga komisioni vlerësues nuk është i lejuar.

Te kontrata “Furnizim me pjesë rezervë dhe riparimi i automjeteve zyrtare” me vlerë prej 132,678€, njëri nga kriteret e vendosura në dosjen e tenderit ishte që operatori ekonomik të ketë së paku dy referenca të natyrës së njëjtë. Ne kemi konstatuar se në dosjen e kompanisë fituese mungojnë këto referenca.

Në drejtoratin e administratës së përgjithshme nuk ka zyrtarë përgjegjës (logjistikë) që merret me mbajtjen e evidencave për shpenzimet e derivateve dhe servisimet për automjetet e komunës. Ne nuk na është ofruar në mënyrë analitike vlera e shpenzuar për servisim dhe vlera e shpenzuar e derivate për secilin automjet. Sipas drejtorisë se financave dhe raportit të freebalancit, shpenzimet për servisime dhe mirëmbajtje për vitin 2013 ishin 31,333€ dhe për derivate 158,117€. Komuna, gjithashtu, nuk mban evidenca lidhur me fletudhëtimet mbi kilometrat e kaluara, me çka do të konfirmohej norma e shpenzimeve të derivateve dhe nëse automjetet janë përdorë për qëllime zyrtare. Praktika të njëjta ishin edhe në Qendra Kryesore për Mjekësi Familjare (QKMF). Ekziston një kontratë për “Riparinin dhe mirëmbajtjen e veturave zyrtare” por që nuk dihet se cilët ishin artikujt e servisimit dhe për cilat automjete. Po ashtu, rast i ngjashëm ishte edhe me furnizimin me goma të automjeteve në QKMF. Sipas deklaratës së zyrtarit përgjegjës për menaxhim me vetura në QKMF gjatë vitit 2012 dhe 2013 ishin furnizuar me 36 goma të përdorura, ndërkaq pagesa ishte bërë për goma të reja. Sipas pohimeve të zyrtarit për menaxhimin e autoparkut në QKMF, kjo kishte ndodhur me urdhërin e Drejtorit të shëndetësisë. Veprimi si i tillë ngrit dyshime për pagesa të parregullta si dhe përmban elemente të mashtrimit.

Tek të gjitha kontratat e rishikuara tek projektet kapitale ne kemi vërejtur se deklarata mbi disponueshmërinë e mjeteve nuk është nënshkruar nga ZKF, siç kërkohet me LPP. Tek kontratat Ndërtimi i AMF-së në Fshatin Novosellë e Ulët me vlerë prej 38,607€, dhe Ndërtimi i AMF-së në

Ramoc me vlerë 40,026€, kemi vërejtur që zotimi i mjeteve për këto kontrata për vitin 2013 është bërë nga 5,000€ për secilën kontratë. Po ashtu, te këto kontrata, sigurimi i ekzekutimit në dosjen e tenderit ishte kërkuar të jetë 10% e vlerës së kontratës, ndërsa operatori ekonomik kishte dorëzuar sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 500€. Raste të njëjta ishin edhe te kontratat “Ndërtimi i rrugës në fshatin Damjan” në vlerë 470,102€, “Ndërtimi me asfalt i rrugës në fshatin Gërqin” me vlerë 338,433€, “Ndërtimi i parkut memorial në fshatin Meje” me vlerë prej 1,060,774€, “Ndërtimi me asfalt i rrugës Rogove-Ujz” me vlerë prej 234,763€.

Praktikat e mira

Publikimi i njoftimeve në ueb faqen e Komunës, madje edhe për kuotim të çmimeve në masë të madhe, është një praktikë shumë e mirë të cilën e bën komuna e Gjakovës. Shumica e komunave të tjera në Kosovë, nuk publikojnë kuotimin e çmimeve. Kjo është një indikator që duhet vlerësuar, pasi që i mundëson sidomos bizneseve të vogla qasje në tenderët me vlera nën 10.000 euro. Ligji nuk kërkon që këto njoftime të publikohen në ueb faqen e KRPP-së dhe publikimi i tyre me vetë iniciativë të komunës është praktikë e cila duhet të merret si shembull edhe nga autoritetet e tjera kontraktuese.

Komuna e Gjakovës është e para që ka adoptuar platformë të veçantë në internet në të cilën publikon të dhëna lidhur me fituesit e tenderëve. Në këtë platformë publiku mund të mësojë se cilat janë kompanitë të cilat kanë fituar më së shumti nga tenderët e komunës. Kjo praktikë duhet përcjell edhe nga komunat e tjera.

Kontrata për Furnizim me Naftë

Në Komunën e Gjakovës, në tenderin për furnizim vjetor me derivate të naftës, fitues është kompania NPT D&Z nga Gjakova. Kjo kompani ka qenë në konkurrencë me operatorin më të madh Petrol Kompani. Në këtë tender konkurrenca ka qenë minimale, vetëm minimumi ligjor prej dy ofertave është plotësuar. Megjithatë ky tender është përcjellë me disa probleme të cilat janë evidentuar nga monitorimi ynë. Në këtë tender kalkulimi i çmimit të litrit të naftës, dosja e tenderit për poentimin e kompanisë fituese dhe kualiteti i naftës nuk është përcaktuar me kontratë.

Nga praktikat e gjertanishme të monitorimit ne kemi vërejtur se komunat e Kosovës, naftën e paguajnë duke u bazuar në çmimet që kompania sjell nga çmimi i naftës në berëz. Zakonisht ky çmim merret nga PLATTS, kompani kjo e specializuar dhe mirënjohur për çmimet e naftës në tregjet ndërkombëtare. Sidoqoftë KDI ka pasur vërejtje për këtë formë të kalkulimit të çmimit, pasi që e njëjta nuk është bërë nga institucioni por nga kompania. Në çdo rast kur mungon mbikëqyrja dhe kontrolli ka hapësirë që çmimet të mos kalkuloohen drejtë dhe ekziston rrezik për rritjen e çmimeve. Në komunën e Gjakovës, çmimi kalkulohet në një formë tjetër. Në këtë rast kompania sjell faturën me të cilën është furnizuar me naftën me shumicë dhe në këtë faturë i llogaritet premiumi. Ky është një problem shumë i madh, për shkak se kompania e kontraktuar naftën në treg mund ta blejë me

çmime shumë të larta krahasuar me ato të berzës ndërkombëtare dhe prapëseprapë komuna është e obliguar që të bëjë pagesën mbi këtë bazë.

Kështu krahasuar me çmimin e naftës për muajin korrik, për të cilën ne kemi siguruar faturat e pagesës komuna e Gjakovës, çmimin e shumicës për naftë, pa llogaritur premiumin e paguan më së shtrenjti. Gjakova naftën për litër pa premium e paguan 1.19 euro (kjo nënkupton çmimin e naftës në tregun me shumicë) këtij çmimi pastaj i shtohet premiumi prej 0.04 euro. Rrjedhimisht kjo e bënë çmimin për një litër naftë 1.23 euro. Në anën tjetër çmimi me shumicë i naftës dallon tek kompanitë e tjera të cilat sigurojnë bursën nga PLATTS. Për shembull kompania “Graniti Petrol” çmimin e naftës për litër pa premium e kalkulon 1.14 euro, ndërsa kompania tjetër “Petrol Company” çmimin e naftës për të njëjtin muaj e kalkulon 1.11 euro. Rrjedhimisht vërehet se vlera e premiumit në kontratat e naftës nuk është i vetmi indikatorë matës se cili do të jetë çmimi përfundimtar i litrit për naftë. Në fakt komuna e Gjakovës në këtë rast është dëmtuar nga forma se si ka kalkuluar çmimin për rreth dyfishin e premiumit që paguan për një litër naftë.

Problemi i kalkulimit të çmimit të naftës nga komuna në komunë vërehet se është problem i cili po ndikon që komunat të humbin në vlerën për para dhe konkurrenca në këtë sektorë të mos jetë e drejtë dhe e ndershme. Për më tepër kontribut të jashtëzakonshëm në këtë situatë kanë dhënë edhe institucionet qendrore të prokurimit publik të cilat nuk kanë përcaktuar formë të detajuar të tenderimit të naftës përmes nxjerrjes së një rregullore dhe duke mos u dhënë qasje komunave në çmimin e naftës në berëzat ndërkombëtare.

Komunat në të gjitha rastet kanë hapësirë të tepërt për të dizajnuar dosjen e tenderit, formën e vlerësimit dhe formën e faturimit të çmimit. Rrjedhimisht shumica e komunave të Kosovës paguajnë artikullin me çmim më të lartë sesa vlera në treg, madje me disa cent më tepër. Kur kësaj i shtohet fakti se komunat shpenzojnë qindra mijëra euro në këtë artikull për ngrohje dhe vetura, ky çmim është i pa arsyeshëm. Në çdo rast që komuna paguan një artikull me çmim më të lartë sesa vlera e tij në treg kjo përbën dështim të prokurimit dhe humbje të arsyes për të ekzistuar kontrata me operatorë ekonomik.

Forma e poentimit të operatorit ekonomik gjithashtu është problem në vete i cili mund të bëjë që operatori ekonomik më i shtrenjtë të fitoj tenderin, si pasoj e lojës me formën se si është dizajnuar dosja e tenderit dhe forma e poentimit. Në këtë kontratë përveç naftës është tenderuar edhe benzina, vaji për vetura dhe uji për xham. Të gjitha sasi të para masës kanë qenë një (1). Operatorët në këtë formë kanë mundur të ofertojnë me çmime minimale në artikujt e tjerë dhe të rrisin vlerën në naftë, pasi që ky artikull është kryesori dhe paramasat nuk kanë qenë reale. Në këtë formë në poentim operatori do të dilte i ulët, mirëpo gjatë implementimit të kontratës, komuna do të humbiste para për shkak të hartimit jo profesional të dosjes së tenderit. Paramasat do të duhej të ishin të parashikuara me vlerat reale të cilat do të shpenzoheshin, duke u bazuar në shpenzimet e viteve paraprake, dhe në këtë formë edhe çmimet e operatorëve do të reflektonin çmimet në njësi dhe sasi reale. Pesë artikujt është dashur të ndahen në lloje, apo të paktën në tre lloje, duke ndarë naftën, benzinën dhe artikujt e tjerë si vajrat, ujin e xhamave dhe ujin antifriz. Nëse kjo do të ndodhte, komuna do të mund të zgjedhte

mes ofertës më të mirë për secilin artikull pasi që në pesë artikuj këto dy kompani me siguri se do të ofronin çmime të cilat do të ishin të ndryshme dhe më të favorshme për komunën.

Sidoqoftë komuna në këtë rast ka mundur të përfshijë një klauzolë në dosje të tenderit apo edhe kontratën me operatorin ekonomik, që pavarësisht çmimit të naftës në berzat ndërkombëtare dhe çmimet me shumicë të artikullit, çmimi që paguan komuna nuk mund të tejkaloj çmimin e shitjes së naftës me pakicë. Në këtë formë pavarësisht dokumenteve që do të sillte në komunë operatori, do të sigurohej se të paktën artikulli paguhet me çmimin e pakicës dhe jo siç është tani që për këtë artikull paguhet më shtrenjtë sesa në tregun me pakicë.

Tenderi për ndërtimin me kubëza betoni i rrugëve dhe trotuareve

Tenderi i komunës së Gjakovës për ndërtimin e rrugëve dhe trotuareve me kubëza të betonit, është kontratë një vjeçare. Ky tender nuk i referohet asnjë projekti në veçanti. Komuna ka lidhur tender pa objekt të kontratës. Projekti nuk ka paramasa dhe vlera është vetëm e supozuar 500.000,00 €. Për më tepër në këtë projekt edhe çmimet e kubëzave të betonit janë në vlera shumë më të larta sesa çmimet e tregut. Komisioni për vlerësimin e tenderëve, ka rekomanduar që ky tender të anulohet, për shkak se çmimet e konkurrentëve apo ofertuesve nuk janë në përputhje me tregun, mirëpo zyrtarët e komunës megjithatë e kanë nënshkruar këtë kontratë. Dallimi i çmimeve është problemi tjetër që përcjell tenderin e kubëzave të betonit, pasi që oferta më e lirë ishte 68,20 euro, ndërsa oferta më e shtrenjtë 1.059,65 euro. Ky dallim i ofertave është shumë domethënës dhe më së mirë e tregon rrjedhën e tenderit në fjalë.

Në praktikën e prokurimit publik në Kosovë, të gjithë tenderët për kontrata të punëve shpallen për projektet e caktuara. Në këtë formë lidhet nga një kontratë për secilin projekt dhe rrjedhimisht lejohet konkurrencë në këtë sektorë. Komuna e Gjakovës për një vit i ka dhënë monopol kompanisë “Beni” që ta shtroj secilën rrugë që kërkohet me kubëza të betonit. Në dosjen e tenderit është paraparë që përmes këtij tenderi të përzgjidhen më shumë se një operatorë, për të zhvilluar mini-konkurrencë sa herë që ka projekte për ndërtim rrugësh apo trotuareve me kubëza të betonit. Nga qasja në dokumente zyrtare ne kemi parë se në këtë tender kontratë është nënshkruar vetëm me një kompani. Kjo lloj kontrate kornizë, pa pasur projekte të veçanta, është lidhur për të përmbushur nevojat e kreut komunal, në mënyrë që të realizoj sa më shpejt dhe lehtë punët në teren, në raste të fushatave elektorale. Në këtë mënyrë Kryetari i Komunës mund të shtroj me kubëza të betonit cilën do rrugë, pa pasur nevojë për tender të veçantë. Kjo tregon se në këtë kohë komuna ka funksionuar pa projekte të planifikuara dhe punët janë kryer sipas nevojave politike dhe jo planeve zhvillimore.

Të gjitha paramasat e projektit janë me numër një (1), që do të thotë se nuk dihen paramasat e vërteta dhe nevojat e komunës, se sa do të shpenzohen kubëza, me çfarë trashësie dhe sa artikuj të tjerë për ndërtimin e rrugëve, artikuj të cilët janë periferik. Në këtë formë operatorit i është lënë hapësirë shumë e madhe që të manipuloj me çmimet për njësi. Në këtë formë çmimet e kubëzave janë shumë të larta, përkatësisht 18 euro për M² tek kubëzat me trashësi 6.0 centimetër (cm), ndërsa kubëzat e trashësisë 8.0 cm çmimi është 14 euro. Dosja e tenderit ka edhe rreth 30 pozicione të tjerat të cilat janë ofertuar

në të shumtën e rasteve me çmime minimale 0.10 euro ose 0.20 euro. Kjo tregon se operatori ekonomik ka planifikuar që të gjitha rrugët t'i shtroj me kubëza të trashësisë 6.0 cm dhe në këtë formë ta ngarkojë sa më shumë financiarisht komunën përmes kësaj kontrate.

Në krahasim me dy komunat paraprake të monitoruara, Mamushën dhe Prizrenin, të cilat çmimin për kubëza betoni e kanë pasur rreth 8 euro, Gjakova paguan çmime shumë më të larta. Duke rritur çmimet tej mase në pozicione të caktuara, ku operatori e dinë se shpenzohen sasi të mëdha të artikullit, siç është rasti i kubëzave në këtë tender, çmimi përfundimtarë i projektit mund të dal shumë më i shtrenjtë sesa që duket në ofertën e operatorit. Kjo ndodh për shkak se kubëza në këto raste harxhohen shumë fish më shumë sesa të gjithë artikujt e tjerë së bashku, ku kompania ka ofertuar me 0.10 apo 0.20 euro. Kjo do të thotë se tek çmimet për njësi në kontratat kornizë, konkurrenca nuk është e drejtë dhe e ndershme, pasi që oferta më e lirë, në fakt mund të jetë më e shtrenjtë.

Komisioni i përzgjedhur nga komuna, ka rekomanduar që të anulohet procedura e tenderit për shkak të çmimeve të cilat janë në shpërputhje me ato të tregut. Sidoqoftë komisioni ka vlerësuar se çmimet janë shumë të ulëta, duke e anashkaluar çmimet e larta në disa prej kategorive në të cilat më së shumti do të shpenzohet nga komuna. Në këtë formë, nga hartimi i gabuar i dosjes së tenderit, me ose pa qëllim, i ka dhënë hapësirë operatorëve ekonomik që të ofertojnë në atë mënyrë që çmimet për njësi të mos jenë domodoshmërisht çmimet më të lira në çmimin total të kontratës. Në këtë formë përveç dëmtimit të buxhetit të komunës, operatorët e tillë e dëmtojnë edhe konkurrencën e ndershme. Një operatorë i cili në të gjitha pozicionet ka vendosur çmimet reale të tenderit, në këtë rast do të ishte shumë më i shtrenjtë në ofertë, për shkak të formës së poentimit. Në dosjen e tenderit është dashur të parashihen sasi të artikujve, në mënyrë që çmimet e ekzagjeruar në kategoritë të cilat shpenzohen më shumë, do të reflektonin në çmimin e përgjithshëm të ofertës. Kjo për shkak se nuk ka kuptim që pusetat dhe kubëzat të jenë më numrin e njëjtë të sasisë. Në një rrugë ku bëhet shtrimi me kubëza ka mesatarisht 5 deri në 10 puseta varësisht nga gjatësia e rrugës. Në anën tjetër sasia e kubëzave të shpenzuara është shumë më e madhe dhe kjo gjithsesi duhet të reflektoj në para masat e dosjes së tenderit.

Tenderi për Mirëmbajtjen Dimërore të Rrugëve

Tenderi për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve të komunës së Gjakovës i lidhur në vitin 2012 është i ndarë në dy pjesë. Ky tender i komunës së Gjakovës sikurse edhe dy tenderët paraprak, ka disa probleme të cilat kanë përcjell mbarëvajtjen e tij, e që për pasojë kanë dëmtuar buxhetin e komunës. Së pari dosja e tenderit të këtij projekti nuk është e hartuar në mënyrë të duhur dhe profesionale, ajo ka lënë shumë vend dhe specifikime të pa qarta. Paramasat e këtij tenderi kanë qenë të hartuara po ashtu në mënyrë të gabuar. Puna e kompanive është matur me kilometër gjatësi dhe jo orë pune apo m², siç janë format më të zakonshme të tenderimit të mirëmbajtjes së rrugëve. Po ashtu çmimet e këtij tenderi janë shumë të larta dhe nuk përkrijnë me çmimet e tregut për mirëmbajtje të rrugëve, përkatësisht pastrimin nga bora. Për më tepër komuna e Gjakovës, në dosjen e tenderit nuk ka paraparë, pajisjet teknike të domosdoshme të cilat duhet t'i kenë kompanitë për të kryer me sukses punën e tyre.

Dy kompanitë fituese janë kompania Cabrati, për mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe rurale pjesa e parë dhe kompania Lekaj, për pjesën e dytë të kontratës. Që të dy këto kompani janë nga komuna e Gjakovës dhe për rastësi emri i njërit nga kompanitë fituese korrespondon me mbiemrin e ish Kryetarit të Komunës, nën autoritetin e të cilit edhe është nënshkruar kontrata.

Rrugët në komunën e Gjakovës, janë përshkruar në dosje të tenderit me metër katrorë (m²), sidoqoftë oferta e kompanive për pastrimin e rrugëve është kërkuar të jepet në km gjatësi. Kjo do të thotë se pavarësisht gjerësisë së rrugës kompania ka ofruar çmimin e saj për pastrimin e një kilometër, në dy kategori. Pastrimi me hedhje të kripës, i cili është më i zakonshëm për shkak se të gjitha rrugët pastrohen me hedhje të kripës përveç rrugëve të pa asfaltuara. Pozicioni i dyletë i çmimit është kërkuar pastrimi i rrugëve pa hedhje të kripës, i cili është më i rrallë. Problemi me këtë mënyrë të hartimit të dosjes së tenderit qëndron në faktin se komuna ka ndryshuar formën standarde të tenderimit që është puna me orë, e cila aplikohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe pastrimi i rrugëve duke u bazuar në m². Komuna në këtë rast ka shpikur formë të re të hartimit të paramasave të dosjes së tenderit dhe formës së poentimit. Në fakt komuna e Gjakovës ka qenë rasti veçantë në të tre tenderët e analizuar, pasi që ka pasur dallime thelbësore me standardet e tenderimit në Kosovë. Sikurse edhe në dy rastet paraprake edhe këtë herë këto standarde të ndryshme kanë qenë në dëm të buxhetit komunal. Për më tepër në dosjen e tenderit kompanive nuk u janë vënë kushte specifike rreth përshtatshmërisë teknike dhe profesionale. Nuk është kërkuar numër i caktuar i punëtorëve teknik apo profesional, nuk është kërkuar makineri specifike, referenca apo kontrata me vlera specifike etj.

Kompania Cabrati, ka fituar pjesën e parë të kontratës, në të cilën ka ofertuar me çmim prej 75 euro, për pastrimin e 1 km rrugë me hedhjen e kripës dhe 50 euro, pastrimin e rrugëve pa hedhjen e kripës. Këto çmime janë shumë të larta krahasuar me çmimet e tjera të tregut. Përkundër që paramasat dallojnë dhe askund në komunat e tjera të monitoruara apo edhe në Ministrinë e Infrastrukturës, nuk kemi hasur në forma të tilla të dosjes së tenderit, ne kemi vërejtur se këto çmime janë shumë më të larta krahasuar me komunat e tjera si Prishtina, Gjiçani apo edhe Ministria e Infrastrukturës, çmimet e të cilave nëse zbërthehen në kilometër gjatësi kushtojnë nga 25 deri në 50 euro, pastrimet me hedhje të kripës. Në këtë rast për çdo kilometër të pastruar, komuna e Gjakovës ka humbur prej 25-50 euro.

Kompania Lekaj, ka pasur çmime më të lira pasi që e njëjta ka ofertuar me 37 euro për pastrimin e një kilometër rrugë pa hedhje të kripës dhe 39 euro me hedhje të kripës. Edhe në këtë rast sasia e vlerësuar ka qenë një (1) dhe kompania ka pasur hapësirë që të manipuloj me dy çmimet për njësi. Përderisa në kontratën e parë dallimi mes pastrimit të rrugës me hedhje të kripës është 25 euro, në këtë kontratë dallimi është vetëm dy (2) euro, vlerë kjo shumë simbolike. Dallimet në mes të çmimeve të dy kontratave janë shumë të larta dhe kjo ka qenë dashur të jetë një alarm për zyrën e prokurimit në rastin e përzgjedhjes së fituesve të pjesëve.

Komuna e Gjakovës në këtë dosje të tenderit, nuk ka vënë kërkesa teknike dhe profesionale. Të tilla kritere vënë të gjitha autoritetet kontraktuese për t'u siguruar se kompanitë kanë pajisjet dhe stafin e duhur, që u mundëson realizimin e suksesshëm të kontratës. Një numër minimal i kontratave dhe referencave, pajisjeve teknike apo edhe stafit, duhet t'u kërkohej secilës kompani, në të kundërtën,

mund të pranohen oferta nga kompani të pa përgjegjshëm dhe të cilat do të dështojnë në implementimin e kontratës. Në komunat e tjera kompanive u kërkohet, stafi i mjaftueshëm, pajisjet teknike të duhura, si dhe numri i ekspertëve apo stafit të kualifikuar i cili është garancë e punë së duhur të kompanisë.

Konkluzione

- Në tre tenderët e analizuar, komuna e Gjakovës ka pasur dosje të tenderit të cilat kanë dal jashtë standardeve dhe legjislacionit kosovar;
- Komuna e Gjakovës, ka pasur probleme me çmimet e larta tre tenderët e analizuar;
- Mënyra e llogaritjes së çmimit të naftës në Gjakovë ka dëmtuar buxhetin e kësaj komune;
- Forma e poentimit dhe llogaritjes së çmimeve në dosjet e tendeve janë të gabuara, pasi që ofertat me çmimin më të lirë, mund të jenë më të shtrenjtat në implementim, si rezultat i lojës me çmimet e njësisive;
- Tenderi për kubëza të betonit ka thyer Ligjin e Prokurimit, pasi që një operator është kontraktuar për të shtruar të gjitha rrugët e komunës, pa plane konkrete dhe pa asnjë vlerë të kontratës;
- Tenderi për kubëza të betonit është tender me çmime shumë të larta në dy njësi
- Tenderi për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve i komunës së Gjakovës është tender me çmime shumë të larta dhe ka dëmtuar buxhetin e Komunës;